

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 96/19, 110/19 dhe 121/24), si dhe të nenit 160 paragrafit 2 të Ligjit për Arsimin Fillor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19, 229/20, 3/25, 74/25, 250/25 dhe 111/26), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli:

**Rregullore
për plotësimin e Rregullores
për masat dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve financiare
për shkollat fillore shtetërore**

Neni 1

Në Rregulloren për masat dhe kriteret për shpërndarjen e mjeteve për shkollat fillore shtetërore nr. 12-15999/1, të datës 19.12.2025, në nenin 11, pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, i cili thotë:

„Shkollat fillore shtetërore dhe shfrytëzuesit e tjerë, të cilëve u shpërndahen mjete në përputhje me këtë rregullore, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i dorëzojnë raport për mjetet e shpenzuara sipas zërave dhe destinimeve, pas përfundimit të çdo tremujori, brenda afatit prej 15 ditësh“.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e miratimit të saj.

**Министерка за образование и наука,
проф. д-р Весна Јаневска, с.р**

**Nr. 12-9711/1
23.07.2026
Shkup**